

02.03.22



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"
VLORE
ZYRA E PROTOKOLL - ARKIVËS
NR. 228
DATA 25.02.2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE DHE PËRPUTHSHMËRISË PËR
ARSIMIN, SPORTIN DHE RININË

Nr. 274/ Prot.

Tiranë, më 25.2.2022

Lënda: Dërgohet urdhri për njohje dhe zbatim

AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 219, Tiranë

QENDRËS SË SHËRBIMEVE ARSIMORE

Adresa: Bulevardi "Zhan D'Ark", Nr. 23, Tiranë

QENDRËS NDËRINSTITUCIONALE TË RRJETIT AKADEMIK SHQIPTAR

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 219, Tiranë

UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORE

Adresa: Skelë, Rruga "Kosova", 9401, Vlorë


Bashkëlidhur gjeni për njohje dhe zbatim urdhrin nr. 36, datë 25.02.2022 të Ministrit të Arsimit, dhe Sportit, "Për hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë "Doktoratë" në "Studime Gjuhësore, Letrare dhe Kulturore" në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë".

Bashkëlidhur ju dërgojmë listën e personelit akademik të kategorisë "Profesor", të propozuar nga Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë dhe të miratuar si udhëheqës të studentëve që do të ndjekin programin e studimit të ciklit të tretë "Doktoratë" në "Studime Gjuhësore, Letrare dhe Kulturore". Në vijim të zhvillimit të studimeve, në rast se do të ketë ndryshime të personelit akademik nga lista bashkëlidhur, këto ndryshime të paraqiten në MAS për miratim.

Qendra e Shërbimeve Arsimore të marrë masa për pajisjen me numra matrikullimi të studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të tretë "Doktoratë" në "Studime Gjuhësore, Letrare dhe Kulturore" në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë, pas dërgimit të listës nga Ministria përgjegjëse për arsimin.

Duke ju falënderuar,

SEKRETARI PËRGJITHSHËM



Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 23, AL 1001, Tiranë. E-mail: info@arsimi.gov.al www.arsimi.gov.al

Studime Gjuhësore, Letrare e Kulturore				
Nr	Titulli	Emër	Mbiemër	Numri i Udhëheqjeve
1	Profesor	Roland	Zisi	1
2	Prof. Asoc	Armela	Panajoti	2
3	Prof. Asoc	Bledar	Toska	1
4	Prof. Asoc	Monika	Hasani	1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 1274 Prot.

Tiranë, më 25.2.2022

URDHËR

Nr. 96, Datë 25.2.2022

PËR

**HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË DOKTORATË
NË "STUDIME GJUHËSORE, LETRARE DHE KULTURORE", NË
UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI" VLORE**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të neneve 35 dhe 77 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë "Doktoratë" në "Studime Gjuhësore, Letrare dhe Kulturore" që do të zhvillohet në gjuhën shqipe.
Studimet e doktoratës të zhvillohen me kohë të plotë pranë njësisë/ve bazë ose me kohë të zgjatur në ato raste kur doktoranti është i punësuar si personel akademik në një institucion tjetër të arsimit të lartë, apo si personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar.
Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diploma e gradës shkencore "Doktor" në "Studime Gjuhësore, Letrare dhe Kulturore", në Fakultetin e Shkencave Humane, në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë, referuar nivelit 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Aktivizimi i programit të studimit të ciklit të tretë "Doktoratë" në "Studime Gjuhësore, Letrare dhe Kulturore", në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë, fillon brenda njëzet e katër muajve, në bazë të legjislacionit në fuqi.
3. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë të respektojë kriteret për personelin akademik të angazhuar për programin e studimit, lidhur me numrin maksimal të udhëheqjeve që mund të kenë në të gjitha IAL-të, në varësi të titullit akademik që zotëron udhëheqësi, në bazë të legjislacionit në fuqi.

4. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë të marrë masa që programi i studimit t'i nënshtrohet procesit të akreditimit, sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
5. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin e formës së diplomës së këtij programi studimi, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe të përshtatë aktet e brendshme rregullatore, në zbatim të këtij urdhri.
6. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë të ndjekë procedurat për regjistrimin e gradës shkencore "Doktor" në regjistrin shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademikë, pranë strukturës përgjegjëse kompetente.
7. Ministria e Arsimit dhe Sportit ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin e arsimit të lartë, në zbatim të këtij urdhri.
8. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë për Arsimin, Sportin dhe Rininë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Agjencia e Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

